



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 03.03.2022

Drejtuar : “GRADECI” SH.P.K

Adresa: Lagjja ”Çlirimi” ,rruga kryesore ,godina dykatëshe ,nr.10, Çorovodë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar - mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-19606-02-14-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje per nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2022”.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike **Nr. 23 datë 21 .02. 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. GRADECI SH.P.K

L68714401S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 9 397 102(nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dy) lekë pa TVSH .

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. EUROPETROL DURRES ALBANIA SH.A

K24010212N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 9 499 976 (nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH .

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. EUROPETROL DURRËS ALBANIA SH.A

K24010212N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 9 499 976 (nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH .

arsyet e mëposhtme

Operatori Ekonomik “ Europetrol Durrës” SHA nuk plotëson pikat 2.3.2 dhe 2.3.5 për “Aftësitë teknike dhe profesionale” në dokumentat standarde të tenderit .

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë ose autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) të lëshuar nga nga Njësia Vendore, sipas pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 20, të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.*

Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik “ Europetrol Durrës” SHA komisioni konstatoi se ky Operator Ekonomik nuk ka paraqitur Licenc ose Autorizim për tregëtim me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj të lëshuar nga organi i Pushtetit Vendor sikurse **parashikohet në Ligjin nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.** Lidhur me licencen e shoqërisë “**Kantina e Pijeve Skrapar**”, të paraqitur në këtë procedurë prokurimi Komisioni Gjykon se nuk mund të merret në konsideratë, pasi ky i fundit nuk është pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon të paktën një pikë shitje/furnizimi të mallit brenda territorit të Bashkisë Skrapar , e pasqyruar kjo tek të dhënat në QKB dhe e pasqyruar me Niptet (Adresat) Sekondare, shoqëruar me Certifikatë Pronësie ose Kontratë Qeraje.*

Nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik të QKB -së të operatorit pjesëmarrës në këtë procedurë “EuroPetrol Durres” SH.A. rezultoi se nuk kishte adresë ushtrimi aktiviteti brenda territorit të Bashkisë Skrapar .

Komisioni i vlerësimit të ofertave thekson se Autoriteti Kontraktor kërkon vetëm dy mënyra disponimi të pikës për tregëtimin e karburantit brenda territorit të Bashkisë Skrapar në pronësi ose me qera, e për rrjedhojë ky O.E nuk ka dëshmuar se disponon të paktën një pikë shitje/furnizimi karburanti nga vetë Operatori Ekonomik “ Europetrol Durrës” SHA . Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykoi se Operatorët Ekonomik janë të detyruar të paraqisin oferta në përputhje me

kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme .

Shënim : theksojmë se KVO –ja i është referuar vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.183/2021 datë 30.04.2021 në procedurën e vitit të kaluar, ku u kontaktuan mangesit e mësipërme të këtij Operator Ekonomik ,K.P.P vendosi që KVO –ja ta Skualifikoj Operator Ekonomik

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “GRADECI SH.P.K” se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9 397 102 (nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dy) lekë pa TVSH totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Drejtori
Edmond OMERI